



**“Pyetje-përgjigje
në lidhje
me
çështjet
e Besimit/Imanit
dhe
Mosbesimit/Kufri”**

Përgjigjet dietari i nderuar:

Shejh Salih ibn Feuzan el-Feuzan

“Pyetje-përgjigje në lidhje me çështjet e Besimit/Imanit dhe Mosbesimit/Kufri”

Përgjigjet dijetari i nderuar:

Shejh Salih ibn Feuzan el-Feuzan

Përktheu:

Kastriot Mazreku

©Lejohet shpërndarja në të gjitha format, me kusht që të mos ndryshohet asgjë nga përmbajtja dhe të mos përdoret për qëllim përfitimi financiar.

Botimi i parë elektronik në facebook në faqet:

Shejh Abdurrezak ibn Abdul-Muhsin el-Bedr, Shejh Shenkiti.

Dhjetor, 2014.

Hyrje

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit.

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve, mëshira e Allahut dhe shpëtimi i Tij qoftë për të Dërguarin e Allahut, për familjen e tij dhe shokët e tij.

Pastaj...

Këto pyetje të rëndësishme nga kërkuesit e dijes dhe thirrësve drejt Allahut, drejtuar dijetarit të madh Shejh Salih ibn Feuzan el-Feuzan, Allahu i Lartësuar e ruajt dhe e beftë të begatë diturinë e tij, e i bëftë dobi me të Islamit dhe muslimanëve, ua parashtrojmë atij me shpresë për t'u përgjigjur me atë që i mundësoi Allahu atij nga dituria prej Librit dhe Sunnetit, ndoshta Allahu bënë dobi me to:¹

Pyetja e parë:

Me çfarë bëhet kufri i madh apo felëshimi(*ridde-ja*)?

A është i veçantë vetëm me bindje/besim(*Itikad*), refuzim(*xhuhud*) dhe përgënjeshttrim, apo është më i përgjithshëm?

Përgjigje:

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit.

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve, mëshira e Allahut dhe shpëtimi i Tij qoftë për Profetin tonë Muhamed, për familjen e tij dhe shokët e tij, pastaj:

Sigurisht çështjet e besimit janë shumë të rëndësishme, dhe është obligim që të mësohet besimi me të gjitha kapitujt e tij dhe me të gjitha çështjet e tij, dhe ato të merren nga njerëzit e dijes, nuk mjafton vetëm parashtrimi i pyetjeve dhe hedhja e pyetjeve, sepse sa më tepër shtohen pyetjet dhe përgjigjet për të, injoranca do të jetë me e madhe!

Kësisoj, është obligim për atë që dëshiron t'i bëjë vetës dobi dhe t'i bëjë dobi vëllezërve të tij musliman, që ta mësojë besimin nga fillimi deri në fund, dhe ta mësojë me kaptinat dhe çështjet e tij, dhe atë ta merr nga dijetarët dhe prej librave të tyre bazë, prej librave të selefëve të devotshëm dhe me këtë do të zhdukët injoranca dhe nuk do të ketë nevojë për pyetje të shumta, si dhe do të ketë mundësi që t'ua sqarojë njerëzve dhe t'i mësojë injorantët, sepse atëherë është bërë kompetent në akide.

Gjithashtu nuk merret besimi vetëm nga librat, apo vetëm me lexim dhe studim, sepse nuk merren çështjet e tij fillimisht nga librat dhe as nga studimi, mirëpo merren me përcjellje nga njerëzit e dijes dhe të argumentit, të cilët e kuptuan atë dhe i shtjelluan çështjet e tij...

Këshilla në lidhje me këtë çështje është obligim...

¹Shënim:Këto pyetje që i janë parashtruar Shejh Feuzan-it u është përgjigjur drejtpërdrejt, pastaj janë nxjerrë nga incizimi dhe janë shënuar!

Ndërsa, sa i përket asaj që qarkullon tani në këtë fushë,
prej pyetjeve të shumta rreth akides dhe çështjeve të saj nga disa njerëz
të cilët nuk e mësuan atë më parë;
Apo disa njerëz të cilët flasin për akide dhe çështjet e saj me padituri;
Apo duke u mbështetur në leximet e tyre në libra apo studimeve të tyre,
në këtë mënyrë veçse i shton çështjes mister, apo u shton paqartësive paqartësi tjera
dhe i pengon përpjekjet dhe prodhon mospajtim,
për shkak se nëse ne u referohemi pikëpamjeve tona, pa e marrë diturinë prej burimit të saj
dhe të zotëve të saj, mirëpo të mbështetemi vetëm në leximet tona dhe pikëpamjet tona,
sigurisht që mendjet dallojnë dhe perceptimet dallojnë dhe për rrjedhojë shkaktohet
mospajtim në këtë çështje të rëndësishme.
Feja jonë ka ardhur me unitet, bashkim dhe mos përçarje,
dhe ka ardhur me miqësim ndaj besimtarëve dhe armiqësim ndaj jobesimtarëve,
dhe kjo nuk arrihet përveçse me marrjen e çështjeve të fesë nga burimi i tyre
dhe nga dijetarët të cilët e bartën atë para tyre, dhe e mësuan atë me *sened*
dhe ua kumtuan atë atyre që erdhën më pas, e kjo është rruga e diturisë së vërtetë në akide
dhe në lëmi të tjera, mirëpo akide-ja është më me rëndësi, për arsye se ajo është themel
dhe se mospajtimi në të dërgon në humbje dhe në ndarje në mesin e muslimanëve.

Dhe nuk ka nevojë për përpilimin e librave të reja në akide, përkundrazi na mjaftojnë
librat e dijetarëve të selefëve dhe pasueseve të tyre. Prej Allahut vjen sukcesi.

Përgjigje:

Mosbesimi(*kufr*-i i madh) dhe felëshimi/dezertimi(*ridde*-ja),
realizohen me kryerjen e ndonjë anuluesi nga anuluesit e Islamit të njohura tek dijetarët,
kësisoj kush kryen diçka prej tyre, jo me injorancë me të cilën arsyetohet,
kësisoj ai me këtë bëhet dezertues(*murted*) dhe bëhet jobesimtar
dhe ne na takon që ndaj tij të gjykojmë me atë që shfaqet prej tij,
nga fjala e tij apo nga vepra e tij, ne gjykojmë ndaj tij me këtë,
sepse neve nuk na takon veçse të gjykojmë me të dukshmen,
kurse çështjet e zemrave, sigurisht që nuk i di veçse Allahu i Lartësuar.
Kush shqipton mosbesim(*kufr*) apo vepron mosbesim(*kufr*),
ne gjykojmë ndaj tij sipas fjalës së tij, në përputhje me atë që e shqiptoi ai
dhe në përputhje me veprën e tij, kur ajo të cilën e ka vepruar ai,
apo e ka shqiptuar të jetë prej çështjeve të felëshimit(*ridde*-s),
përveçse nëse është injorantë, injorancë me të cilën arsyetohet, ose të jetë i detyruar.
Kjo është në çështjet e dukshme(të njohura. sh.p.) të akides në Kuran dhe Sunnet,
siç është *shirk*-u i madh dhe *kufr*-i i madh, kurse sa i përket çështjeve të fshehta,
patjetër për ato duhet ngritja e argumentit duke ia sqaruar kundërshtarit të saktën
në atë çështje.

Pyetje e dytë:

Ndonjëri thotë: “Besimi (*Iman*-i) është fjalë, bindje dhe vepër, mirëpo vepra në të është kusht plotësues.” Dhe gjithashtu thotë: “Nuk ka mosbesim (*kufr*), veçse me bindje.”

A është kjo fjalë nga fjalët e Ehli Sunnetit apo jo?

Përgjigje:

Ai që e thotë këtë nuk e ka kuptuar *Iman*-in, e as nuk e kuptuar *akid*-en, dhe pikërisht është kjo që pohuam në hyrje se është obligim për të, që ta mësoj akiden nga dijetarët dhe ta përvetësoj atë nga burimi i saj i vërtetë, dhe do ta kuptoj përgjigjen e kësaj pyetje.

Fjala e tij: “Imani është fjalë, vepër dhe besim” - pastaj thotë:

“Vepra është kusht në plotësinë e Imanit dhe në saktësinë e tij,” kjo është kontradiktë!!

Si mund të jetë vepra prej Imanit, pastaj thotë vepra është kusht,

dhe është e ditur se kushti është jashtë të kushtëzuarit, kjo është kontradiktë nga ana e tij!

Ky është që dëshiron të bashkoj ndërmjet fjalës së selefëve dhe fjalës së të vonshmëve

dhe ai nuk e kupton këtë kontradiktë, ngase ai nuk e njeh falën e selefëve,

dhe as nuk e kupton realitetin e fjalës së të vonshmëve,

e kështu dëshiron që të bashkoj ndërmjet tyre.

Imani është fjalë, vepër dhe besim. Dhe vepra është prej Imanit dhe ajo (vepra) është Iman,

Dhe nuk është ajo kusht prej kushteve të saktësisë së Imanit, apo kusht plotësues,

apo të tjera prej këtyre fjalëve të cilat qarkullojnë tani.

Pra, Imani është shqiptim me gjuhë, besim me zemër dhe veprim me gjymtyrë

dhe shtohet me adhurime dhe pakësohet me mëkate.

Pyetja e tretë:

Veprat, a janë kusht (*rukn*) në Iman dhe pjesë prej tij, apo ajo është kusht plotësues në të (Iman)?

Përgjigje:

Kjo është e ngjashme me pyetjen e mëparshme,

parashtruesi i kësaj pyetje nuk e di realitetin e Imanit.

Prandaj edhe luhatet: “A janë veprat pjesë prej Imanit apo janë kusht për të?

Ngase ai nuk e ka përvetësuar *akide*-n nga burimi i saj dhe themelet e saj, e as nga dijetarët.

Dhe siç përmendëm nuk ka vepër pa Iman, dhe as Iman pa vepër,

këto të dyja janë të ndërlidhura, dhe vepra është prej Imanit, madje është Iman:

Veprat janë Iman, fjalët janë Iman, besimet/bindjet janë Iman,

dhe të gjitha bashkë janë Iman në Allahun e Madhëruar, Iman në Librat e Tij,

në të dërguarit e Tij, në Ditën e Fundit dhe Iman në caktim, të mirin dhe të keqin.

Pyetja e katërtë:

Cilat janë grupet e murxhivë, bashkë me përmendjen e mendimeve të tyre në çështjen e Imanit?

Përgjigje:

Murxhitë janë katër grupe:

Grupi i parë: Ata të cilët thonë Imani është vetëm njohje (*ma'rife*), edhe nëse nuk e bënë vërtetimin (*tasdik-un*)...

Ky është mendimi i xhehmive, dhe ky është mendimi më i keq dhe më i shëmtuar, ky është *kufri* në Allahun e Madhërishëm, sepse idhujtarët e parë, Faraoni, Hamani, Karuni e Iblisi secili nga ata e njohën Allahun e Madhëruar, dhe e njihnin *Iman*-in me zemrat e tyre, mirëpo meqenëse as nuk deklaruan me gjuhët e tyre dhe as nuk e praktikuan me veprat e tyre, nuk u bëri dobi atyre kjo njohje.

Grupi i dytë: Esharitë: Të cilët thanë se Imani është vetëm besim i zemrës (*tasdik*), ky është mendimi i esharive, dhe ky mendim gjithashtu është i kotë, ngase jobesimtarët besonin me zemrat e tyre, dhe e dinin se Kur'an-i është i vërtetë dhe se i Dërguari është i vërtetë, edhe hebrenjtë dhe të krishterët e dinë këtë:

الَّذِينَ آتَيْنَاهُمُ الْكِتَابَ يَعْرِفُونَهُ كَمَا يَعْرِفُونَ أَبْنَاءَهُمْ وَإِنَّ فَرِيقًا مِّنْهُمْ لَيَكْتُمُونَ الْحَقَّ وَهُمْ يَعْلَمُونَ

"Atyre të cilëve ua dhamë Librin, e njohin atë sikurse i njohin bijtë e tyre"

(Bekare, 146)

Pra, ata e besonin atë (Muhamedin) me zemrat e tyre! Thotë i Lartësuari për idhujtarët:

قَدْ نَعْلَمُ إِنَّهُ لَيَحْزُنُكَ الَّذِي يَقُولُونَ فَإِنَّهُمْ لَا يُكَذِّبُونَكَ وَلَكِنَّ الظَّالِمِينَ بِآيَاتِ اللَّهِ تَجْحَدُونَ

**"Sigurisht, Ne e dimë se të pikëllon ty ajo që ata e thonë,
ata në të vërtetë nuk të përgënjeshtrojnë ty,
mirëpo mizorët ajetet e Allahut i refuzojnë"**

(Enam, 33)

Këta as nuk e shqiptuan me gjuhët e tyre dhe as nuk e praktikuan me gjymtyrët e tyre, përkundër se ata e njihnin për të vërtetë (Muhamedin si të dërguar) me zemrat e tyre, prapë ata nuk u bënë besimtar.

Grupi i tretë: Kerramitë, të cilët janë në të kundërtën e esharive, të cilët thonë:

Imani është shqiptim me gjuhë edhe nëse nuk e beson me zemër, dhe s'ka dyshim në kotësinë e kësaj fjale, ngase hipokritët

të cilët janë në shtresën e fundit të zjarrit thonë me gjuhët e tyre:

"Dëshmojmë se nuk ka të adhuruar me meritë pos Allahut dhe se Muhamedi është i dërguari i Allahut," mirëpo ata nuk e besojnë këtë

dhe as nuk e marrin të vërtetë këtë me zemrat e tyre, siç thotë i Lartësuari:

إِذَا جَاءَكَ الْمُنَافِقُونَ قَالُوا نَشْهَدُ إِنَّكَ لَرَسُولُ اللَّهِ وَاللَّهُ يَعْلَمُ إِنَّكَ لَرَسُولُهُ

وَاللَّهُ يَشْهَدُ إِنَّ الْمُنَافِقِينَ لَكَاذِبُونَ ﴿١﴾ اتَّخَذُوا أَيْمَانَهُمْ جُنَّةً فَصَدُّوا عَنْ سَبِيلِ اللَّهِ

"Kur të vijnë tek ti hipokritët thonë: Dëshmojmë se vërtetë ti je i dërguari i Allahut, Allahu e di se ti je i Dërguari i Tij, dhe Allahu dëshmon se hipokritët janë gënjeshtar. I morën betimet e tyre mburojë, kësisoj pengojnë nga rruga e Allahut."
(Munafikun, 1-2)

Ka thënë i Lartësuari:

يَقُولُونَ بِأَفْوَاهِهِمْ مَا لَيْسَ فِي قُلُوبِهِمْ ﴿٢٧﴾

"Deklarojnë me gjuhët e tyre atë që nuk është në zemrat e tyre."
(Ali Imran, 167)

Gurpi i katërtë: Murxhitë el-Fukaha: Ky grup është më i lehtë në 'Irxha'², të cilët thonë: Imani është besim me zemër dhe shqiptim me gjuhë dhe në të nuk futen veprat, ky mendim është i murxhive fukaha, dhe ky mendim është i kotë gjithashtu.

Pyetja e pestë:

Mospajtimi ndërmjet Ehli Sunnetit me murxhitë fukaha, a është për veprat e zemrës, apo të gjymtyrëve?
A është ky mospajtim gjuhësor/terminologjik apo real/kuptimor?
Shpresoj nga shkëlqesia juaj shtjellim.

Përgjigje:

Mospajtimi i tyre është në vepra, mospajtimi i murxhive fukaha me masën e Ehli Sunnetit është mospajtim në veprat e dukshme, sikurse Namazi, Agjërimi, Haxhi. Ata thonë: "Ajo (vepra sh.p.) nuk është prej Imanit, mirëpo ajo është kusht për Imanin, ose kusht saktësues, ose kusht plotësues."
Dhe kjo është fjalë e kotë siç e kuptuam.
Dhe mospajtimi mes tyre dhe e Ehli Sunetit është mospajtim kuptimor dhe nuk është mospajtim gjuhësor, ngase ata thonë:

² "Irxha-ja" gjuhësisht vjen në dy kuptime:

Kuptimi i parë: Vonim (te'khir) siç e përmend i Lartësuari dialogun ndërmjet Musait dhe vëllait të tij Harunin me Faraonin dhe parinë e tij, që kjo e fundit i kishte thënë Faraonit:

"I thanë: Vonoje (*Er'xhih*) atë dhe vëllanë e tij." قَالُوا أَرْجَاهُ وَأَحَاهُ ﴿٢٨﴾

Sipas këtij kuptimi janë quajtur mur'xhieh, sepse e vonuan (e shtynë, e nxorën) veprën nga domethënia e Imanit.

Kuptimi i dytë: I 'Irxha-së' është shpresë (Err-rraxhe), sipas këtij kuptimi janë quajtur mur'xhieh (ithtarët e shpresës), sepse i morën vetëm citat e shpresës në të cilat përmendet falja dhe mëshira e Allahut. (sh.p.)

“Imani as nuk shtohet, as nuk pakësohet, nuk shtohet me adhurime dhe as nuk pakësohet me mëkate.”
Dhe Imani i njerëzve është i barabartë, ngase ai (Imani) tek ta është vetëm vërtetim/besim (*tasdik*) me zemër dhe deklaram me gjuhë! Dhe kjo fjalë është e kotë.

Pyetja e gjashtë:

Cili është gjykimi ndaj atij që i lë të gjitha veprat e dukshme në mënyrë gjithëpërfshirëse, mirëpo i shqipton dy dëshmitë³ dhe i pranon detyrimet, por ai nuk praktikon asgjë prej tyre asnjëherë, a është ky musliman, apo jo? Duke e ditur se ai nuk ka ndonjë arsytim legjitim që e pengon kryerjen e këtyre obligimeve?

Përgjigje:

Ky nuk është besimtar, ai që beson me zemrën e tij, mirëpo nuk vepron me gjymtyrët e tij, zbrazet nga praktikimi i të gjitha veprave pa arsytim, ky nuk është besimtar, sepse Imani siç përmendëm më parë dhe siç e përkufizoi atë Ehli Suneti dhe Xhemati, ai është: “Shqiptim me gjuhë, besim me zemër dhe praktikim me gjymtyrë.” Nuk arrihet Imani, përveçse me bashkimin e këtyre gjërave, ai që braktisë njërin prej tyre, me këtë ai nuk është besimtar.

Pyetja e shtatë:

A është e saktë kjo thënie:
"Kush thotë: “Imani është fjalë, vepër dhe besim, shtohet dhe pakësohet, me këtë është distancuar komplet nga ‘Irxha’-ja, edhe nëse thotë s’ka *kufr* (nuk del prej fesë *sh.p.*) veçse me bindje (*Itikad*) dhe refuzim (*Xhuhud*)?”

Përgjigje:

Kjo është kontradiktë!!!
Kur të thotë nuk ka *kufr* veçse me bindje (*Itikad*), apo refuzim (*Xhuhud*), këtë e kundërshton fjala e tij: Imani është deklaram me gjuhë, besim me zemër dhe veprim me gjymtyrë, kjo është kontradiktë e qartë. Sepse kur Imani të jetë deklaram me gjuhë, besim me zemër dhe praktikim me gjymtyrë dhe se ai shtohet me adhurime dhe pakësohet me mëkate... Kuptimi i tij është se kush heq dorë nga diçka prej kësaj ai më këtë nuk është besimtar.

³ “Dëshmia e parë është: “Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me meritë përveç Allahut”
(Esh’heduen La ilahe il-Allah)

Dëshmia e dytë është: “Dëshmoj se Muhammedi është i Dërguari i Allahut”
(Esh’heduen enne Muhammeden ResulAllah)

Pyetja e tetë:

A është kjo thënie e saktë, apo jo:

“Se kush e fyen Allahun dhe e fyen të Dërguarin, nuk është *kufr* në vetën e saj, mirëpo kjo është shenjë dhe tregues për atë që është në zemër nga nënçmim dhe nënvlerësimi?”

Përgjigje:

Kjo thënie është e kotë, ngase Allahu gjykoi ndaj hipokritëve me mosbesim(*kufr*) pas Imanit si rezultat i fjalës së tyre:

"Nuk kemi parë sikurse këta lexuesit tanë, me stomak më të pangopur dhe më frikacak në përballje me armikun."

Me këtë synonin të Dërguarin e Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, dhe shokët e tij, kështu Allahu zbriti për ta fjalën e Tij të Lartësuar:

قُلْ أَبِاللَّهِ وَآيَاتِهِ وَرَسُولِهِ كُنْتُمْ تَسْتَهْزِئُونَ ﴿٦٥﴾ لَا تَعْتَذِرُوا قَدْ كَفَرْتُمْ بَعْدَ إِيمَانِكُمْ ﴿٦٦﴾

"Thuaju: A me Allahun, ajetet e Tij dhe të Dërguarin e Tij ishit duke u tallur?!

Mos u shfajësoni ju veçse mohuat pas besimit tuaj."

(Teube, 65-66)

Dezertuan për shkak të kësaj thënie, dhe nuk e kushtëzoi mosbesimin(*kufr*-in) e tyre se ata e besonin këtë(që e thanë. sh.p.) me zemrat e tyre,

përkundrazi Ai gjykoi ndaj tyre me mosbesim(*kufr*) si shkak i kësaj thënie.

Po kështu është fjala e Tij e Lartësuar:

وَلَقَدْ قَالُوا كَلِمَةَ الْكُفْرِ وَكَفَرُوا بَعْدَ إِسْلَامِهِمْ ﴿٧٤﴾

"Dha ata veçse thanë fjalë mosbesimi(*kufr*-i) dhe mohuan pas Islamit të tyre"

(Tevbe, 74)

E ndërliidhi mosbesimin(*kufr*-in) me shqiptimin e fjalës së tyre të mosbesimit(*kufr*-it).

Pyetja e nëntë:

Cili është gjykimi ndaj atij që e fyen Allahun dhe të Dërguarin e Tij, dhe e fyen fenë, dhe kur të këshillohet për këtë çështje, e shpjegon me fitimin e furnizimit (rrizkut), a është ky jobesimtar, apo musliman që duhet të ndëshkohet dhe të edukohet? Dhe a ka në këtë rast ndonjë dallim ndërmjet fyerjes (fjalës fyese. sh.p.) dhe fyesit (shqiptuesit të fjalës. sh.p.)?

Përgjigje:

Nuk i lejohet njeriut të bëjë *kufër* në Allahun me fjalë, apo me vepër, apo me bindje dhe të thotë: "Kjo është për arsye të kërimit të furnizimit."

Furnizimi është nga Allahu i Lartësuar, Allahu i Madhëruar thotë:

وَمَنْ يَتَّقِ اللَّهَ يَجْعَلْ لَهُ مَخْرَجًا ۖ وَيَرْزُقْهُ مِنْ حَيْثُ لَا يَحْتَسِبُ ۚ

"Kush i druhet Allahut, do t'i bëjë atij zgjidhje dhe do ta furnizoj nga nuk e llogaritet."
(Talak, 2-3)

Kësisoj, furnizimi është në dorë të Allahut, Allahu i Madhëruar gjykoj me mosbesim (*kufër*) për atë që e vlerëson dynjanë ndaj ahiretit, thotë i Lartësuari duke i përshkruar felëshuesit dhe hipokritet:

ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمْ اسْتَحَبُّوا الْحَيَاةَ الدُّنْيَا عَلَى الْآخِرَةِ وَأَنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الْكَافِرِينَ

"Kjo, sepse ata e pëlqyen jetën e dynjasë ndaj ahiretit dhe se Allahu nuk e udhëzon popullin jobesimtar."
(Nahl, 107)

Kështu gjykoj ndaj tyre se ata e braktisën Imanin e tyre për shkak se ata dëshirojnë të jetojnë me njerëzit dhe të jenë bashkë me njerëzit:

وَلَوْ أَنَّهُمْ رَضُوا مَا آتَاهُمُ اللَّهُ وَرَسُولُهُ وَقَالُوا حَسْبُنَا اللَّهُ سَيُؤْتِينَا اللَّهُ مِنْ فَضْلِهِ

وَرَسُولُهُ إِنَّا إِلَى اللَّهِ رَاغِبُونَ

"Dhe sikur ata të ishin të kënaqur me atë që u dhuroi Allahu dhe i Dërguari i Tij Dhe të thoshin na mjafton Allahu, do të na dhurojë Allahu nga mirësia e Tij dhe i Dërguari i Tij, ne tek Allahu shpresojmë."
(Teube, 59)

Sikur të mbështeteshin tek Allahu, do t'i furnizonte Allahu i Madhëruar.

Pyetja e dhjetë:

Çka është dispozita në lidhje me ata që ngritin statuja dhe ndërtojnë tyrbe dhe varreza, dhe ndërtojnë mbi to Xhami dhe ndërtime, duke qëndruar aty njerëz dhe (duke hedhur) pasuritë, dhe duke bërë për ato njerëz që e mbikëqyrin atë, duke ua mundësuar njerëzve adhurimin e atyre (varreve), rrotullimin rreth tyre (tavafin), duke u lutur e duke prerë kurban për to?

Përgjigje:

Gjykimi për të është se bënë kufr (të madh. sh.p.) me këtë vepër, sepse vepra e tij është thirrje për mosbesimin (*kufr*-in). Ngritja e tyrbeve dhe ndërtimi mbi to dhe thirrja e njerëzve për adhurimin e tyre dhe duke bërë punonjës për të, kjo tregon për kënaqësinë e tij me këtë çështje, dhe se ai fton në mosbesim (*kufr*) dhe thërret në humbje, Allahu na ruajt.

Pyetja e njëmbëdhjetë:

A është legjitim namazi pas imamit i cili kërkon ndihmë nga të vdekurit dhe kërkon zgjidhje prej tyre?
Dhe si është me atë person që gënjen dhe miraton gënjeshtër dhe u shkakton lëndime njerëzve të mirë dhe u prinë njerëzve. (në namaz. sh.p.)
A i jepet atij përparësi në namaz kur të njihet ai me gënjeshtër dhe mëkat të madh (*fisk*)?

Përgjigje:

Nuk vlen namazi pas idhujtarit i cili bënë *shirk* të madh i cili të nxjerrë prej fesë, dhe i thërret të vdekurit dhe kërkon ndihmë prej tyre, ky është *shirk* i madh që të nxjerrë nga feja.
Kështu, ky person nuk është musliman nuk vlen namazi i tij, e as i atyre që lidhen pas tij, kushtëzohet që imami të jetë besimtar në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij, dhe të jetë praktikues i fesë Islame, formalisht dhe esencialisht.
Kurse sa i për ketë atij personi tjetër dhe atë që e bënë ai, ai është mëkat prej mëkateve të mëdha: Gënjeshtër, dhe kryen mëkate të mëdha që janë nën *shirk* (të madh sh.p.) dhe i lëndon muslimanët... Këto janë prej mëkateve të mëdha, nuk janë *kufr* (i madh), dhe ky nuk duhet që të vendoset imam për njerëzit, megjithatë ai që vjen dhe i gjen njerëzit duke u falur me të, ai falet pas tij dhe nuk duhet të falet i veçuar, derisa të gjejë një imam të mirë të udhëzuar pastaj shkon tek ai.

Pyetja e dymbëdhjetë:

Janë disa hadithe me të cilat u argumentuan disa për atë që i lë të gjitha veprat se ai është besimtar me besim të mangët, siç është hadithi:

"Nuk kanë punuar ndonjë mirësi kurrë" dhe hadithin e kartës (*bitakës*) dhe hadithe të tjera, si është përgjigja për këto?

Përgjigje:

Kjo bënë pjesë në argumentimin me të paqarta (*muteshbih*), dhe kjo është rruga e të lajthiturve për të cilët ka thënë Allahu i Madhëruar:

فَأَمَّا الَّذِينَ فِي قُلُوبِهِمْ زَيْغٌ فَيَتَّبِعُونَ مَا تَشَبَّهَ مِنْهُ

"Kurse ata të cilët në zemrat e tyre kanë shtrembërim i ndjekin të paqartat prej tij"
(Ali Imran, 7)

Kështu, ata i marrin argumentet e paqarta dhe i braktisin argumentet e qarta të cilat i shpjegojnë dhe i qartësojnë ato..

Patjetër që e paqarta duhet të kthehet tek e qarta, kështu themi:

Kush i lë veprat për ndonjë arsye të ligjshme dhe nuk i mundësohet atij derisa edhe vdes, ky është i arsyetuar, dhe mbi të barten këto hadithe...

Sepse ky person i shqiptoi dy dëshmitë duke i besuar kuptimet e tyre, duke qenë i sigurtë me Allahu e Madhëruar, e pastaj vdiq në atë gjendje, apo nuk arriti të veprojë, mirëpo ai i deklaroi dy dëshmitë bashkë me sinjeritetin me Allahun e Madhëruar dhe Teuhidin, siç tha Profeti, *sal-lAllahu alejhi ve sel-lem*:

"Ai që thotë s'ka të adhuroar me meritë pos Allahut dhe bënë *kufër* në atë që adhurohet përveç Allahut, veçse është bërë e shenjtë gjaku dhe pasuria e tij."⁴

Dhe ka thënë:

"Allahu ia ka ndaluar zjarrin atij që thotë:

S'ka të adhuroar me meritë pos Allahut, e me këtë dëshiron kënaqësinë e Allahut."⁵

Ky person nuk i është mundësuar veprimi megjithëse ai shqiptoi dy dëshmitë dhe i besoi kuptimet e tyre, dhe ishte i sigurtë me Allahun, mirëpo ai nuk pati mundësi për të vepruar derisa vdiq, ky është personi që futet në Xhenet për shkak të dy dëshmimeve, dhe për të ka për qëllim hadithi i kartës (*bitak-ës*) dhe hadithet tjera të cilat kanë ardhur me këtë kuptim, ata të cilët do të dalin prej zjarrit të cilët nuk kanë punuar ndonjë të mirë kurrë, sepse nuk u është mundësuar megjithëse ata shqiptuan dy dëshmitë dhe u futën në Islam, ky është bashkimi ndërmjet haditheve.

⁴ Transmeton Muslimi në "Iman" (23), Ahmedi (6/394);

⁵ Transmeton Buhariu në "Es-saleh" (415), Muslimi në "Mesexhid" (33);

Pyetja e trembëdhjetë:

Cili është gjykimi ndaj atij që i lutet të tjerëve përveç Allahut dhe ai jeton në mesin e muslimanëve në gjuhën e Kur'anit, a konsiderohet ky musliman i përlyer me shirk(të madh. sh.p), apo konsiderohet idhujtar?

Përgjigje:

Atij që i ka arritur Kur'ani dhe Sunneti në atë mënyrë që ka pasur mundësi ta kuptoj nëse do të dëshironte, e pastaj nuk vepron me të dhe as nuk e pranon atë, me këtë atij veçse i është ngritur argumenti, dhe nuk arsyetohet me injorancë, sepse i ka arritur atij argumenti, Allahu i Madhërishëm thotë:

وَأُوحِيَ إِلَىٰ هَٰذَا الْقُرْآنُ لِأُنذِرَكُمْ بِهِ ۖ وَمَنْ بَلَغَ ﴿١٩﴾

“Mua më është shpallur ky Kur'an që me të t'ju tërheq vërejtjen juve dhe atij që i komunikohet”

(Enam, 19)

E njëjtë është, jetoj ai në mesin e muslimanëve apo në mesin e jomuslimanëve... Secilit të cilit i ka arritur Kur'ani në mënyrë që e kupton atë po të dëshiroj ta kuptoj, e pastaj nuk punon me të, sigurisht me këtë ai nuk është musliman dhe as nuk arsyetohet me injorancë/padituri.

Pyetja e katërbëdhjetë:

A kushtëzohet në ngritjen e argumentit kuptimi i argumentit(*fehmul huxh-xheh*), kuptim të qartë, të padyshimtë, apo mjafton vetëm ngritja e tij? Shpresojmë shtjellimin e kësaj çështje me përmendjen e argumenteve.

Përgjigje:

Këtë e përmendëm në përgjigjen e kaluar, se kur t'i arrin atij argumenti prej Kur'anit dhe Sunnetit, në atë mënyrë që e kupton atë po të dëshiron... Do të thotë i arrin atij në gjuhën e tij, dhe në formë që e kupton atë, e pastaj i neglizhon atë dhe nuk vepron me të, ky nuk arsyetohet me padituri, sepse ai është neglizhent.

Pyetja e pesëmbëdhjetë:

Shpallja për jobesimtar(*tekfir*-i) i Shejhul Islam Ibn Tejmijes- Allahu e mëshiroftë- ndaj grupit të cilët ndaluan në dhënien e Zekatit – kur e vepruan këtë dezertuesit nga arabët- a ishte kjo për arsye të refuzimit të tyre ndaj obligueshmërisë, apo vetëm për shkak të ndalimit dhe mosdhënies?

Përgjigje:

Këtë e kanë shtjelluar dijetarët, kanë thënë:

Nëse mos dhënësi i Zekatit e refuzon obligueshmërinë e tij, ky është jobesimtar dhe vritet për arsyet të felëshimit(*ridde*-s), kurse nëse nuk e jep atë për shkak të koprracisë dhe e beson obligueshmërinë e tij, ky luftohet derisa t'i nënshtrohet dhënies së Zekatit, nuk gjykohet me mosbesim(*kufr*), por luftohet si mos dhënës i Zekatit derisa të merret prej tij.

Ndërsa ajo që i është atribuar Shejhul Islam Ibn Tejmijes se ai ka shpallur jobesimtar pa përfundim, unë nuk kam hasur në këtë fjalë.

Pyetje e gjashtëmbëdhjetë:

Cili është gjykimi i zëvendësimit të sheriatit Islam me kushtetuta tokësore, siç janë kushtetuta franceze, britanike e të tjera përveç tyre, si dhe në ato kushtetuta kanë vendosur ligjin islam në çështjet e trashëgimisë, e martesave?

Përgjigje:

Ai që e shkarkon sheriatin Islam përfundimisht dhe në vend të tij vendos kushtetuta, ky është argument se ai e sheh të lejuar këtë gjë, sepse ai nuk e largoi atë dhe vendosi në vend të tij kushtetuta, veçse ai e sheh këtë(kanun) më të mirë se sheriatu islam, sikur ta mendonte që sheriatu islam është më i mirë se ai, nuk do ta largonte sheriatin dhe në vend të tij të vendoste kushtetuta, kjo është mosbesim(*kufr* i madh) në Allahun e Madhëruar.

Kurse sa i përket atij që ka vendosur që vetëm çështjet e trashëgimisë e martesave të jenë sipas sheriatit, ky është që beson në një pjesë të Librit dhe e mohon pjesën tjetër, kam për qëllim gjykon me sheriat në një pjesë dhe e ndalon në një pjesë, feja nuk mund të copëtohet, gjykimi me sheriat nuk copëtohet, patjetër të zbatohet sheriatu zbatim të përgjithshëm, dhe nuk zbatohet në diçka e të lihet pjesa tjetër.

Pyetja e shtatëmbëdhjetë:

Cili është gjykimi ndaj atij që thotë:

“Se ai që thotë: Kush i lë veprat e dukshme plotësisht, siç e emërtojnë disa dijetarë “lloji i veprës” (*khinsul amel*) se ai është jobesimtar, se këtë thënie e kanë thënë disa grupe të murxhive?”

Përgjigje:

Kjo është njëjtë siç kemi thënë më parë, se veprat janë prej Imanit, vepra është Iman, kush e lë atë (veprën. sh.p.) bëhet lënësi i Imanit, e njëjtë është i braktisë të gjitha veprat plotësisht, nuk vepron asgjë asnjëherë, apo i braktisë disa vepra, sepse ai nuk e llogaritë atë prej Imanit dhe as nuk e sheh se hynë në Iman, kjo hynë tek murxhizmi.

Pyejta e tetëmbëdhjetë:

Shpallja jobesimtar që i bënë selefët- kënaqësia e Allahut qoftë për ta- ndaj xhehmive, ishte *kufër* që të nxjerrë prej fesë apo *kufër* (i vogël) nën *kufër* (të madh), a po me këtë vetëm dëshirohej mospërfillja dhe ashpërsia?

Përgjigje:

Shpallja jobesimtar që selefët ua bënë xhehmive ishte me *kufër* të madh, për arsye se ata i refuzuan fjalët e Allahut të Madhërishëm, dhe thanë: Fjalët e Allahut janë të krijuara, dhe i refuzuan emrat dhe cilësitë e Allahut, ata ishin mohues të cilësive (*mua'tileh*), ata ishin përgënjeshtres të asaj që gjendet në Kur'an dhe Sunnet nga pohimi i emrave dhe i cilësive të Allahut, gjithashtu ata besonin në unifikim (*hulul*-bashkimin e Allahut me krijesa. sh.p.) se Allahu është i në çdo vend, i lartësuar është Allahu nga ajo që ata thonë. Fjalët e tyre rezultojnë në *kufër* të madh, kështu shpallje jobesimtar që selefët ua bënë atyre ishte për shkak të *kufër*-it të madh, përveç atij që ishte injorantë, imitues, që i pasonte duke menduar se ata janë në të vërtetën dhe nuk e njihin medhhebin e tyre dhe nuk e dinte realitetin e fjalëve të tyre, ky mund të arsyetohet me padituri.

Pyetja e nëntëmbëdhjetë:

A ishte përgjithësimi i *tekfir*-it të selefëve ndaj prijësve xhehmi, siç ishte *tekfir*-i i Imam Shafiut ndaj Hafs el-Ferd-it kur tha se Kur'ani është i krijuar, i tha atij Shafi: “*Ke mohuar, pasha Allahun e Madhërishëm*”, siç e përcjellë këtë Lalekeij në shpjegimin e “*Usulul Itikadi Ehli Sunneh*”, dhe sikurse *tekfir*-i ndaj Xhehm ibn Safvanit , Bishër el-Mirisit, Nidh-dhamit, Ebu Hudhejl Al-laf-it, siç e përmend këtë Ibn Batta në “*Ibaneh essugrah*”... Dëshirohej me këtë shpallja jobesimtar(*tekfir*-i) konkret i tyre, apo *tekfir*-i vetëm thënieve të tyre, e jo i konkretisht i tyre?

Përgjigje:

Kush shqipton fjalë mosbesimi(*kufr*-i), apo vepron vepra të mosbesimit(*kufr*-it), ai llogaritet jobesimtar konkretisht. Kështu pra, kush deklaron fjalë mosbesimi(*kufr*-i), apo vepron vepra mosbesimi(*kufr*-i) dhe ai nuk është nga ata që arsyetohen me padituri, ai konsiderohet jobesimtar konkretisht , dhe ne ndaj tij gjykojmë me mosbesim(*kufr*).

Pyetja e njëzet:

Janë përmendur disa terme në librat e Ehli Sunnetit siç janë: Përkushtimi(*Iltizam*), kënaqësia(*Ikna'a*), mosbesimi i shmangies(*Kufrul l'arad*), cili është kuptimi i këtyre termave?

Përgjigje:

Mosbesimi(*kufr*-i) është disa lloje:Prej tyre është mosbesimi(*kufr*-i) i shmangies , mosbesimi(*kufr*-i) i përgënjeshtimit, mosbesimi(*kufr*-i) i refuzimit, të gjitha këto janë prej llojeve të mosbesimit(*kufr-it të madh*). Pra, mosbesimi nuk është një lloj i vetëm, mirëpo është disa lloje. Gjithashtu, *kufr*-i ndahet në dy lloje:*kufr* i madh, që të nxjerr nga feja dhe *kufr* i vogël, që nuk të nxjerrë nga feja. Patjetër duhet të mësohen këto çështje dhe njohja e tyre e thukët, *kufr*-i nuk është në të njëjtin gradë.

Pyetja e njëzetënjë:

Cili është kuptimi i fjalës se Shejhul Islam Muhammed ibën Abdul-Vehab-it, Allahu e mëshiroftë, në zhvlerësuesin e tretë prej zhvlerësuesve të Islamit:
“Kush nuk i shpall jobesimtar idhujtarët, apo dyshon në mosbesimin e tyre, apo e konsideron të vërtetë rrugën e tyre, ai është i njëjtë sikurse ata.”?

Përgjigje:

Po, është i njëjtë me ata, sepse ishte i kënaqur me atë në të cilën ata janë dhe u pajtua me atë në të cilët janë ata, kështu kush nuk i shpallë jobesimtar ata, apo kënaqet me atë në të cilën janë, apo i mbron ata, me këtë ai bëhet jobesimtar sikurse ata , ngase ishte i kënaqur me mosbesimin(*kufr*-in) dhe e pranoi atë dhe nuk e refuzoi.

Pyetja e njëzetedytë:

Cili është gjykimi ndaj atij që thotë:

“Nëse personi nuk i konsideron jobesimtar të krishterët për arsye të mos arritjes së ajetit të surës Maide:

 لَقَدْ كَفَرَ الَّذِينَ قَالُوا إِنَّ اللَّهَ ثَالِثُ ثَلَاثَةٍ

“Veçse kanë mohuar ata të cilët thanë:Allahu është i treti prej treve.”
(Maide, 73)

Ai nuk bëhet jobesimtar derisa ta dijë ajetin?

Përgjigje:

Nuk është i kufizuar mosbesimi(*tekfir*-i) i hebrenjve dhe të krishterëve vetëm në suren Maide, përkundrazi mosbesimi i tyre është i shumtë në Kur'an, gjithashtu mosbesimi i tyre është i qartë në fjalët e tyre, në veprat e tyre dhe në librat e tyre të cilët ata i mësojnë, siç është fjala e tyre:
Mesihu është biri i Allahut; Apo fjala e tyre:Allahu është i treti nga të tretë;
Apo fjala e hebrenjve:Uzejri është biri i Allahut;
Apo Allahu është i varfër, ndërsa ne jemi të pasur; Apo dora e Allahut është e shtrënguar;
Apo fjalë të tjera të cilat janë prezent në librat e tyre që kanë para vetës, mosbesimi i tyre është i qartë edhe në kaptinat tjera përveç sures Maide.

Pyetja e njëzetetretë:

Cili është argumenti për legjitimitetin e kushteve të fjalës

“S’ka të adhurar me meritë pos Allahut”(La ilahe il-lAll-llah):

Me dituri(*el-ilm*), nënshtrim(*el-Inkijad*), vërtetësi(*essidku*), sinqeritet(*el-lkhlas*),

dashuri(*el-muhabe*), pranim(*el-kabul*), dhe bindje(*el-jekin*).

Dhe si gjykohet ai që thotë:

“Mjafton dëshmia *“S’ka të adhurar me meritë pos Allahut”* vetëm shqiptimi i kësaj fjale pa këto kushte?”

Përgjigje:

Ky ose është i devijuar, që dëshiron devijimin e njerëzve,

ose është injorantë që nuk di çfarë thotë.

“S’ka të adhurar me meritë pos Allahut” nuk është vetëm shqiptim fjalësh,

mirëpo patjetër përmban kuptim dhe rrjedhime/detyrime,

nuk është vetëm shqiptim shprehjesh me gjuhë,

dhe argument për këtë është fjala e Profetit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem:

**“Kush thotë: *“S’ka të adhurar me meritë pos Allahut”*
dhe i mohon ata që adhurohen, përveç Allahut”⁶**

Apo fjala e tij, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem:

"Allahu ia ka ndaluar zjarrin atij që thotë:

S’ka të adhurar me meritë pos Allahut duke dëshiruar kënaqësinë e Allahut.”⁷

Apo fjala e Profetit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem:

“Jam urdhëruar t’i luftoi njerëzit derisa të thonë:

“S’ka të adhurar me meritë pos Allahut”,

**kur ta thonë këtë ata e kanë të mbrojtur nga unë gjakun dhe pasurinë e tyre,
përveçse me të drejtën e saj.”⁸**

Përveçse me të drejtën e fjalës *“S’ka të adhurar me meritë pos Allahut”*.

Nuk u ndal vetëm në deklarin e fjalës së tyre: *“S’ka të adhurar me meritë pos Allahut”*.

Kur nuk iu përmbajtën të drejtës së saj dhe kjo është zbatimi i detyrimeve të saj

dhe njohja e kuptimit të saj .

Kështu pra, *“S’ka të adhurar me meritë pos Allahut”* nuk është vetëm deklarin fjalësh me gjuhë...

Dhe nga kjo merren këto dhjetë⁹ kushte të cilat i kanë përmendur dijetarët.

⁶ Transmeton Muslimi në *“Iman”*(23), Ahmedi(6/394);

⁷ Transmeton Buhariu në *“Es-saleh”*(415), Muslimi në *“Mesexhid”*(33);

⁸ Transmeton Buhariu, në *“Xhihad”*(2786), Muslimi në *“Iman”*(21), Tirmidhiu në *“Iman”*(2606), Nesaiu në *“Tahrimu dem”*(3971), Ebu Davudi në *“Xhihad”*(2640), Ibn Maxhe në *“Fiten”*(3928), Ahmedi(1/11);

⁹ Në të vërtetë janë shtatë kushte, me siguri Shejhi donte të thoshte ‘shtatë’(sh.p.)

Pyetja e njëzetekatërtë:

Dëshirojmë shpjegimin e fjalës të Lartësuarit:

مَنْ كَفَرَ بِاللَّهِ مِنْ بَعْدِ إِيمَانِهِ إِلَّا مَنْ أَكْرَهَ وَقَلْبُهُ مُطْمَئِنٌّ بِالْإِيمَانِ ﴿١٠٦﴾

“Kush mohon në Allahun pas besimit të tij, përveç kush detyrohet ndërsa zemra e tij është kënaqur me Imanin”

(Nahl, 106)

Shpjegim të thukët si dhe duke sqaruar dispozitën e detyrimit/dhunimit(*Ikrah*-ut) në këtë ajet?

Përgjigje:

Ky ajet argumenton se ai që deklaron fjalë mosbesimi(*kufr*-i), i detyruar për këtë dhe duke mos pasur bindje në ato, mirëpo i thotë ato që të shpëtoj me ato prej detyrimit ky është i arsyetuar, siç është në tregimin e Ammar ibn Jasirit, Allahu qoftë i kënaqur me të, kur e detyruan idhujtarët që ta shaj të Dërguarin, *sal-lAllahu alejhi ve sel-lem*, dhe ta ofendoj atë, refuzuan ta lirojnë derisa ta ofendoj të Dërguarin, *sal-lAllahu alejhi ve sel-lem*, kësaj shqiptoi me gjuhën e tij atë që e kërkonin prej tij, dhe erdhi edhe e pyeti të Profetin, *sal-lAllahu alejhi ve sel-lem*, i tha:

“Si e gjen zemrën tënde?”

Tha: **“Në zemrën time gjej iman për Allahun dhe të Dërguarin,”**

sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, atëherë zbriti Allahu i Madhërishëm:

“Kush mohon Allahun pas besimit të tij, përveç atij që detyrohet dhe zemra e tij është e qetë me besim, mirëpo kush ia zgjeron gjoksin mosbesimit, atë e ka arritur zemërimi i Allahut dhe ka dënim madh, kjo sepse ata e vlerësuat jetën e kësaj bote mbi jetën tjetër.”

Kështu pra, kush thotë fjalë mosbesimi i detyruar për to, duke dashur vetëm t'i shpëtoj dënimit dhe nuk pajtohet me zemrën e tij, kjo është arsyetim me të cilin e arsyetoi Allahu të detyruarin dhe kjo është veçanërisht për të detyruarin, jo për të tjerët. Po ashtu në fjalën e Tij:

إِلَّا أَنْ تَتَّقُوا مِنْهُمْ تُقَنَّةً وَيُحَذِّرُكُمُ اللَّهُ نَفْسَهُ ۗ وَإِلَى اللَّهِ الْمَصِيرُ ﴿٢٨﴾

“përveç nëse është për qëllim ruajtja prej të keqes së tyre. All-llahu ua tërheq vërejtjen me dënim prej Tij, pse vetëm tek All-llahu është e ardhmja.”

(Ali Imran, 28)

Do të thotë prej (të keqes së. sh.p.) jobesimtarëve, kjo hynë në imponim(*Ikrah*), kurse në raste tjera, jo i detyruar, nuk lejohet pajtimi me ta, apo bindja ndaj tyre në atë që kërkojnë nga fjalët e mosbesimit apo veprat e mosbesimit.

Pyetja e njëzetepestë:

Si është gjykimi për miqësimin e jobesimtarëve dhe idhujtarëve?
Si dhe kur ky miqësim llogaritet *kufër* i madh, që të nxjerrë nga feja?
Dhe kur llogaritet të jetë mëkat prej mëkateve të mëdha?

Përgjigje:

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا لَا تَتَّخِذُوا الْيَهُودَ وَالنَّصَرَىٰ أَوْلِيَاءَ بَعْضُهُمْ أَوْلِيَاءُ بَعْضٍ

وَمَن يَتَوَلَّهُمْ مِنكُمْ فَإِنَّهُ مِنَهُمْ إِنَّ اللَّهَ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الظَّالِمِينَ ﴿٥١﴾

**“O besimtarë, mos i zini për miq hebrenjtë dhe të krishterët,
ata janë miq të njëri-tjetrit, ndërsa kush prej jush i miqëson ata,
me këtë ai është prej tyre, sigurisht Allahu nuk e udhëzon popullin mizorë”**
(Maide, 51)

Si dhe fjala e Tij e Lartësuar:

لَا تَجِدُ قَوْمًا يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ ءَاخِرِ يُوَادُّونَ مَنْ حَادَّ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَلَوْ كَانُوا ءَابَاءَهُمْ
أَوْ أَبْنَاءَهُمْ أَوْ إِخْوَانَهُمْ أَوْ عَشِيرَتَهُمْ ؕ أُولَٰئِكَ كَتَبَ فِي قُلُوبِهِمُ الْإِيمَانَ وَأَيَّدَهُم بِرُوحٍ مِّنْهُ

**“Nuk gjen popull që e beson All-llahun dhe Ditën e Gjykimit,
e ta dojë atë që e kundërshton All-llahun dhe të dërguarin e Tij,
edhe sikur të jenë ata (kundërshtarët) prindërit e tyre, ose fëmijët e tyre,
ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre. Ata janë që në zemrat e tyre (Ai) ka skalitur
besimin dhe e ka forcuar me shpirt nga ana e Tij”**
(Muxhadele, 22)

Kësisoj, obligohet armiqësimi i jobesimtarëve dhe urrejtja e tyre dhe mos përkrahja e tyre kundër muslimanëve dhe këputja e lidhjeve me ta nga aspekti i dashurisë,
dhe urrejtja e asaj në të cilën gjenden nga mosbesimi, me të gjitha këto obligohet myslimani që të shkëputet dhe të largohet prej tyre dhe të mos i dojë ata e as t’u ndihmoj atyre kundër muslimanëve dhe as të mos i përkrah ata, as të mos e konsideroj si të vërtetë rrugën e tyre, përkundrazi i shpall për jobesimtar, i quan jobesimtar dhe të devijuar dhe paralajmëron kundër tyre.

Pyetja e njëzetegjastë:

Cila është këshilla juaj për kërkuesit e dijes, për atë që dëshiron t'i rregulloj çështjet e njësimit(*teuhid-it*) dhe idhujtarisë(*shirk-ut*), çështjet e besimit(*Iman-it*) dhe mosbesimit(*kufr-it*)? Dhe cilat janë librat në të cilat keni diskutuar për këto çështje dhe i ke shtjelluar?

Përgjigje:

Për këtë kemi bërë me dije në fillim të përgjigjeve se baza e kësaj janë librat e selefëve të devotshëm.

Ai duhet që tu referohet librave të selefëve të këtij ummeti, katër imamëve dhe para këtyre sahabëve, tabi'inëve dhe pasuesve të tyre prej gjeneratave të ndritshme, dhe këto (shpjegime. sh.p.) gjenden në librat e tyre, falënderimi për këtë i takon All-llahut, në librat e Imanit, në librat e *akide-s* dhe në librat e *teuhid-it*, janë të njohura nga imamët e mëdhenj, Allahu i mëshiroftë, siç janë librat e Shejhul Islam Ibn Tejmijes, librat e imam Ibn Kajjimit, dhe librat e Muhammed ibn Abdul-Vehabit...

Dhe librat e selefëve të devotshëm siç janë: “Kitebu Esh-sheri’ah” i Exhriut, “Sunneh” i Abdullah-ut birit të Imam Ahmedit, “Sunneh” i Hal-lalit, siç është libri “Akidja e Tahaviut” dhe komentari i tij nga Ibn Ebi Izz...

Të gjitha këto janë prej librave të Ehli Sunnetit dhe prej besimeve të drejta të trashëguara nga selefët e devotshëm, atyre le tu kthehet myslimani.

Mirëpo, siç kemi përmendur më parë nuk mjafton vetëm kufizimi në studimi i librave dhe marrja e diturisë prej tyre pa mësues, përkundrazi patjetër duhet takimi me dijetarë, dhe patjetër duhet ulja në tubimet e diturisë, ose në klasa mësimore, ose në tubime të dijes në xhami.

Patjetër të merret dituria nga të zotët e saj, qoftë në besim/akide apo në çështje tjera përveç saj, mirëpo nevoja për akide është më e madhe në këtë aspekt, sepse ajo është themel, dhe se rrëshqitja dhe gabimi në të, nuk është sikurse gabimi në gjëra tjera.

Vetëm prej Allahut vjen sukcesi, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë për profetin tonë Muhammed, për familjen e tij dhe për të gjithë shokët e tij.